

VENDIM¹
Nr. 441, datë 15.6.2016

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vendimi nr. 469, datë 6.5.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës e të modelit të lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1

ELEMENTET E SIGURISË SË LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

I. PËRSHKRIMI I LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

Leja e qëndrimit për të huajt do të jetë në formën e kartës biometrike. Ky dokument përfshin të dhënat biometrike të mbajtësit dhe do të prodhohet si një kartë “*smart*” hibride, me dy *chipe* të ndryshme: me kontakt dhe pa kontakt.

Përmbajtja elektronike e *chipe*-ve përfshin këto aplikime:

- *Chipi*, me kontakt (*Contact Chip*):
- aplikimi Java;
- aplikimi ID;
- aplikimi PKI;
- aplikimi, krahasim në kartë.
- *Chipi* pa kontakt (*Contactless Chip*)
- aplikimi ICAO

II. ELEMENTET E SIGURISË SË LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

1. Materiali

Materiali i kartës, në përputhje me standardet ICAO 9303 dhe ISO 7810, duhet të plotësojë minimalisht këto kërkesa:

- Polycarbonate;
- Jetëgjatësi max. 10 vite;
- Trupi i kartës të jetë UV Dull.

2. Teknika të printimit

Gjatë procesit të printimit do të aplikohen këto teknika:

- OVI Printing;
- Microtext;
- Kinegram;
- Line Structures;
- Guilloches.

Të gjitha elementet e sigurisë që do të përdoren në printimin e kartës në zona të caktuara do të kenë një pamje uniforme.

3. Mbrojtja kundër kopjimit

Një element OVD (Kinegramë) do të aplikohet në faqen e parme të kartës, duke u trupëzuar në strukturën e saj, duke na dhënë kështu një nivel të lartë sigurie kundër kopjimit.

4. Teknika e personalizimit

¹ Ky vendim është përafshuar plotësisht me rregulloren e Këshillit të Evropian (KE) nr. 1030/2002, datë 13 qershor 2002, “Mbi përcaktimin e formës uniforme të lejeve të qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta”, e ndryshuar, Numri CELEX 32002R1030, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 157, datë 15.6.2002, faqe 1–7.

Për t'u siguruar që të dhënat e personalizuara në kartën e lejes së qëndrimit janë të sigurta kundër orvatjeve për ta falsifikuar, të dhënat biografike, përfshirë dhe fotografinë e mbajtësit, si dhe të dhënat e tjera të lejes së qëndrimit, do të integrohen me tej në materialin bazë të kartës, nëpërmjet procesit të personalizimit (lëshimit). Teknika që do të përdoret për këtë qëllim do të jetë “*laser engraving*”.

ANEKS 2

FORMA DHE MODELI I LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

I. TRUPI I LEJES SË QËNDRIMIT

Karta biometrike “Leje qëndrimi” në formatin D1 përbëhet nga shtresa të ndryshme prej materiali “*polycarbonat*”. Procesi i laminimit do ta bëjë trupin e kartës njësh e të pandashëm.

Dimensionet e kartës biometrike “Leje qëndrimi” janë në përputhje me specifikimet ISO 7810, me dimensione, si vijon:

- Gjerësia:

Min. 85.47 mm;

Max. 85.72mm.

- Lartësia:

Min. 53.93 mm;

Max. 54.04 mm.

- Të katër qoshet e harkuara me rreze:

$r = 2.88$

$r = 3.48$ mm (ISO 7813)

II. PËRMBAJTJA E LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

Trupi i kartave biometrike “Leje qëndrimi” është i përbërë nga material “*polycarbonat*” dhe pamja e dy faqeve është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Të gjitha të dhënat, si: portreti (1), nënshkrimi (2), imazhi ghost (3) dhe të dhënat alfanumerike (4) printohen me teknologji *laser engraving*.

Në faqen e prapme të kartës biometrike “Leje qëndrimi” printohet shiriti MRZ (në format 3 rreshta) sipas standardeve ICAO (5).

LEJE QENDRIMI
RESIDENCE PERMIT



REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mblenimi/kupimi
Solji
emri/gjurmë emri
Monika
demonimi/konfirmimi
FRA
vendndalje/lieu de naissance
France
datëlindja/date of birth
01-01-1980
data e lejimit/date of issue
01-01-2014
autoriteti i lëshues/authority
DRKM TIRANË

Tipi/Type: B
Permit No. 123456
nr. serial / serial number
025097407

gjinia/sex
F
data e shkrimit/date of expiry
31-12-2018
nr. personal/personal no.
F05101619A

1
2
3
4

Motivi Qendrimet/Purpose of Stay
PUNE/WORK

Shenime/Notes:
I PUNESUAR, DELTAPLANE

Adresa/Address
Bul.Deshmoret e Kombit,
Nr.3 Tiranë

I<ALB0325422113F05101019A<<<<<
8001017F1512312ALB<<<<<<<<<<<<<
SOLJI<<MONIKA<<<<<<<<<<<<<<<<

